

Maj 2016



**MONITORIMI KOMBETAR:
Implementimi i Ligjit 119/2014
“Për të Drejtën e Informimit”
në nivel të Qeverisjes Vendore**

Realizuar nga: Qendra për Çështje të
Informimit Publik, INFOCIP,
me mbështetjen e Olof Palme Center

Maj 2016





Seria e Studimeve dhe botimeve nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP
Maj, 2016

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Copyright: Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP

*Materiali që përmban ky publikim nuk mund të kopjohet apo riprodhohet ne asnje rrethane.
Te dhenat qe permban ky raport mundet vetëm
të citohet me kusht që të njihet/citohet autorësia e tij përmes referimit të plotë ne tekst të atributëve te autorit
Një kopje e publikimit që përmban materialin e referuar duhet t'i dërgohet INFOÇIP.
Çdo përdorim i parashtrimeve teorike apo i gjetjeve që përmban ky studim,
pa leje dhe/ose nga të tretë është i ndaluar dhe subjekt penalizimi nga legjislacioni ne fuqi per te drejten e autorit*

Drejtor i Studimit & Autor i Metodës:

Gerti Shella

**Researchers të përfshirë në studim per
Përpunimin e të dhënave dhe vizualizimin grafik:**

Ina Biçaku

Dritjon Selmani

Designer & Layout

Altin Aliaj

Publikuar në Tiranë nga Qendra per Çështje të Informimit Publik :

ISBN:

Mbështetur nga:

Olof Palme Center dhe Qeveria Suedeze



Disclaimer:

Gjetjet, rekomandimet dhe opinionet e shprehura ne kete studim, nuk perfaqesojne domosdoshmerisht ato te donatorit apo sponsorizuesit te ketij studimi, por vetem ato te autoreve

Shqipëria është ndër vendet ku për të drejtën e informimit ekzistojnë si garantitë kushtetuese ashtu edhe garantitë ligjore. Sanksionimi i të drejtës së informimit në nenin 23 të Kushtetutës e bën Shqipërinë të dallueshme me shumë vende të tjera ku e drejta e informimit është e sanksionuar vetëm me ligj.

1. Zhvillimi i Kuadrit Kushtetues për të Drejtën e Informimit¹

Përpyqjet për krijimi e kuadrit kushtetues dhe ligjor për të drejtën e informimit në Shqipëri zënë fill që me përmbyshjen e regjimit totalitar. E drejta e informimit u sanksionua për herë të parë në Shqipëri me ligjin nr.7692, datë 31/03/1993 “Për një shtojcë në ligjin nr. 7491, datë 29/04/1991 “ Për dispozitat kryesore kushtetutes”. Ky ligj prodhoi disa amendime tek “Dispozitat Kryesore Kushtetuese²” duke shtuar një kre të veçantë, të titulluar: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut*”. Në nenin 2 të këtij kreu, tek pjesa “Liria e shprehjes së mendimit “, thuhet se: “*E drejta për t’u informuar nuk mund t’i mohohet askujt*”.

Në kohën kur u adoptuan këto ndryshime jashtëzakonisht të rëndësishme, shoqëria civile ishte në një stad embrionale në Shqipërinë post-komuniste. Ajo ende nuk kishte lindur, në kuptimin që të mund të ushtronte ndikimin e saj në raport me sanksionimin e kësaj të drejte në legjislacion. E drejta e informimit në kete periudhe sapo kishte filluar të identifikohet vecmas të drejtës për lirinë e shprehjes edhe në vendet me demokraci të zhvilluar. Për këtë arsye, mund të thuhet se në fazën e parë, DPI në Shqipëri u prezantua në sistemin e brendshëm juridik nga elita vendimarrëse (politike) e kohës, pra nga sipër, dhe jo nga roli apo presioni i shoqërisë civile (nga poshtë lart), e cila, në periudhën që flasim, ishte në stadet e saj embrionale.

Deri në vitin 1994, Shqipëria nuk kishte një kushtetutë të mirëfilltë. Pas shfuqizimit të Kushtetutës së 1976 në vitin 1991, parimet kryesore mbi të cilat bazohet shteti dhe qeverisja ishin të përmbledhura në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në 1994 drafti i Kushtetutës që u përgatit nga maxhoranca në pushtet e kohës (PD) nuk arriti të merrte pëlqimin popullor në referendumin që u organizua për këtë qëllim. Kushtetuta aktuale e RSH u miratua me referendum popullor vetëm 4 vjet më vonë, në vitin 1998. Momenti historik i hartimit të kushtetutës favorizoi inkorporimin në të të parimeve universale të avancuara, një pjesë e të cilave të sanksionuara relativisht vonë në tekstin e konventave më të rëndësishme ndërkombëtare. Mjafton të përmendet fakti se Kushtetuta e Shqipërisë e ka ngritur në nivelin hierarkik të vetë normës kushtetuese Konventën Europianë të Drejtave të Njeriut (neni 17).

Edhe përse i takon të drejtës për informim, Shqipëria hyn sërish ndër ato pak vende të cilat e kanë ngritur atë në nivelin e normës kushtetuese. E drejta për informim është e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; Kreu II, Liritë dhe të Drejtat Vetjake, neni 23 parashikon si më poshtë vijon:

1. *E drejta e informimit është e garantuar.*
2. *Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrjnë funksione shtetërore.*
3. *Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.*

¹ Nga: **Gerti Shella**, autor i studimit, drejtor i INFOCIP.

² Ligji nr. 7491, datë 29/04/1991, Fletore Zyrtare nr.4, faqe 145

Nëse në hartimin e Kushtetutës së vitit 1994, shoqëria civile, për shkak të stave embrionale ku ndodhej zhvillimi i saj, nuk arriti të bëhej pjesë e procesit, në draftimin e Kushtetutës së 1998 (qe është në fuqi sot) disa NGO arritën të sigurojnë një pjesëmarrje efektive në proces, duke ofruar sugjerime konkrete edhe përsa i takon të drejtës së informimit. Sipas procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e datës 21 prill 1998, të Komisionit Parlamentar për Hartimin e Projekt-Kushtetutës rezultoi se³ ka pasur propozime nga OJF lidhur me të drejtën e informimit, të cilat u morën parasysh nga stafi teknik⁴.

E drejta për informim vjen e vendosur pas të drejtës për lirinë e shprehjes në Kushtetutën e Shqipërisë. Rëndësia që iu është dhënë këtyre dy të drejtave në Kushtetutë evidentohet edhe nga fakti se ligjvënësi i ka vendosur ato menjëherë pas të drejtës së jetës, e cila është e drejta më themelore e njeriut (neni 21).

Nga një analizë e kujdesshme e tre paragrafëve të nenit 23 të Kushtetutës vihet re se në paragrafin e parë është sanksionuar ajo që njihet si e drejta për të patur akses në informacionin e ruajtur nga organet e *administratës publike* (open records).

Në paragrafin e dytë është sanksionuar e drejta e çdo subjekti (*fizik apo juridik*) për të marrë informacion mbi veprimtarinë e organeve shtetërore dhe personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Në praktikë boterore të legjislativës për të drejtën e informimit, normat që sanksionojnë këtë të drejtë njihen ndryshe edhe me termin "*sunshine laws*", ose ligje që garantojnë transparencën e veprimtarisë së organeve shtetërore dhe personave që ushtrojnë funksione shtetërore/publike.

Në paragrafin e tretë është sanksionuar e drejta për të pasur akses në mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive dhe që kanë si qëllim të garantojnë të drejtën e subjekteve (fizike apo juridike) për t'u informuar lidhur me procesin vendimmarrës të organeve të zgjedhura publike (qendrore apo lokale). Pjesëmarrja është komponent substancial i të drejtës për informim dhe kushte për garantuar transparencë dhe llogaridhënie në nivel të vendimmarrjes / qeverisjes.

Neni 44 i Kushtetutës paraqet rëndësi përsa i përket mekanizmave garantues lidhur me implementimin e të drejtës së informimit, duke njohur të drejtën për të kërkuar rehabilitim ose zhdëmtim në rast të mos-respektimit të të drejtës së informimit nga organet shtetërore.

Në nenin 48 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj. Pra organet e pushtetit publik kanë së pari, një detyrim kushtetues për t'u përgjigjur kërkesave, duke përfshirë edhe ato që lidhen me të drejtën e informimit, duke respektuar afatet dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Ky nen merr rëndësi të veçantë, veçanërisht në implementimin praktik të ligjit për aksesin në dokumentat zyrtare.

E drejta e informimit në Republikën e Shqipërisë mund të kufizohet vetëm me ligj. siç parashikohet nga neni 17 i Kushtetutës, ky kufizim bëhet "*për mbrojtjen e një interesi publik ose/dhe për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve*".

Disa nga ligjet që kufizojnë të drejtën e informimit në Shqipëri janë: "Për mbrojtjen e të dhënave personale", "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar. Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, "Për Grumbullimin, Administrimin dhe Ruajtjen e Informacionit të Klasifikuar Policor", etj.

³ Krenar Loloci, "Debati Kushtetues, diskutimi në komisionin parlamentar për hartimin e kushtetutës", vëllimi 1, faqe 85.

⁴ Propozimet kanë pasur si qëllim futjen e një neni të ri (nr.9), pas nenit (nr.8) "liria e shprehjes", i cili do të sanksiononte të drejtën e informimit. Si fillim, paragrafi "e drejta e informimit është e garantuar" i ishte bashkëngjitur neni (8), "liria e shprehjes", por me hartimin e një neni të veçantë (9) për të drejtën e informimit ky paragraf u vendos si pjesë integrale e nenit përkatës.

2. Zhvillimi i kuadrit i përgjithshëm ligjor për të Drejtën e Informimit

Kushtetuta e re hyri në fuqi në 22/11/1998. Në të njëjtin vit, Këshilli i Ministrave, në zbatim të detyrimit kushtetues (*nenin 178, paragrafi 2*), filloi të hatojë dhe të paraqesë për miratim në Kuvend projektligjet e nevojshme për vënien në zbatim të kushtetutës së re. Ligjet që rregullonin të drejtën e informimit u kaluan nga Kuvendi i Shqipërisë gati në bllok në korrik të vitit 1999. Këtu përfshiheshin edhe ligjet të cilat e kufizonin të drejtën e informimit.

Dy ishin ligjet kryesore lidhur me të drejtën e informimit në Shqipëri : *Ligji nr. 8503, datë 30/06/1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”*⁵ dhe *ligji nr.8485, datë 12/05/1999 “Kodi i Proçedurave Administrative”*⁶. Të dyja ligjet hyrë në fuqi gjashtë muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare të RSH. Hyrja në fuqi e Kodit të Proçedurave Administrative i ka pararendur ligjit “Për aksesin në dokumentat zyrtare” me vetëm me 6 ditë kalendarike.

Dispozitat e Kodit të Proçedurës Administrative mbi të drejtën e informimit (neni 20⁷ dhe neni 51⁸) synonin të garantonin këtë të drejtë vetëm për pjesëmarrësit në proçedurën administrative dhe vetëm për dokumentet e përdorura në atë proçedurë, në dallim nga ligji nr. 8503, i cili garantonte të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare *në përgjithësi* dhe pa qënë nevoja që kërkuesi të vërtetojë *interesin e vet personal për çështjen*. Thënë ndryshe, dispozitat e Kodit të Proçedurës Administrative lidhur me të drejtën e informimit ishin një *lex specialis* në raport me dispozitat e ligjit nr. 8503.

Duhet vënë në dukje fakti se ligji nr. 8503, u pararend nga ligji nr. 8502, datë 30/06/1999, “Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”⁹, i ndryshuar. Ky ligj është shpallur me dekretin nr. 2408, datë 14/07/1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani dhe ka hyrë në fuqi në 1/12/1999. Duke iu referuar objektit të këtij ligji i cili vepron në respektim të parimit kushtetues “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë shtetërore”, botimi i akteve të organeve shtetërore është kushti thelbësor i transparencës së veprimtarisë së këtyre organeve. Botimet zyrtare janë padiskutim *parakusht* i të drejtës së informimit.

Nga parashtrimet më sipër, rezulton se, në rastin e Shqipërisë, legjislatori (Kuvendi) ka qënë i kujdeshëm në hartimin e legjislacionit lidhur me të drejtën e informimit, duke siguruar përputhshmërinë si me normën kushtetuese ashtu edhe harmonizim me ligjet e tjera.

Po ashtu, nisur nga momenti i hyrjes në fuqi të Kushtetutës në 1998 e deri në plotësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor konform kërkesave që buronin nga dispozitat kalimtare të Kushtetutës, nuk janë verifikuar vonesa (sikurse ndodhi me hartimin e legjislacionit të ri për pronën private, i cili edhe sot e kësaj ditë është subjekt ndryshimesh të vazhdueshme).

⁵ Ligj, Nr.8503, Dt.Aktit:30.06.1999, Dt.Miratimit:14.07.1999, Flet.Zyrtare Nr.22, Faqe:739 (date 26/07/1999)

⁶ Shpallur me dekretin nr.2387, datë 7/06/1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani. Ligj, Nr.8485, Dt.Aktit:12.05.1999, Dt.Miratimit:07.06.1999, Flet.Zyrtare Nr.19, Faqe:578 (datë 20/07/1999)

⁷ Neni 20: **E drejta për t'u informuar** - Të gjithë pjesëmarrësit në një proçedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë proçedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime. E drejta e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të ushtrohet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar. Organi administrativ që zhvillon proçedurën administrative është i detyruar t'u japë informacion pjesëmarrësve në proçedurë edhe në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre.

⁸ Neni 51: **E drejta e palëve të interesuara për t'u informuar**: çdo person gëzon të drejtën për t'u informuar nga administrata në lidhje me zhvillimin e proçedimeve për të cilat ai person është drejtpërdrejt i interesuar. Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon proçedimin, hapat konkretë të ndërmarrë prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër. Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse.

⁹ Ligj, Nr.8502, Dt.Aktit:30.06.1999, Dt.Miratimit:14.07.1999, Flet.Zyrtare Nr.22, Faqe:731

3. Defektet e ligjit 8503/1999

Ligji 8503, datë 30.6.1999 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare*" nuk mund të aplikohet për informacionin e mbajtur nga sektori privat, i cili përherë e më shumë është duke kryer funksione që më parë i përkisnin sferës publike.

Po ashtu, ligji nuk listonte institucionet që konsiderohen "autoritet publik" në kuptimin që vetë ligji i ka dhënë këtij termi.

Afatet e parashikuara në ligjin 8503 për marrjen e informacionit të synuar ishin ndër më të lartat krahasuar me vendet e tjera europiane (për mospranimin ose pranimin e pjesëshëm të kërkesës duheshin 15 ditë nga dorëzimi i saj dhe për plotësimin e kërkesës 40 ditë).

Ligji parashikonte se shkejlja e dipozitive të tij mund të konsiderohet vepër penale dhe referonte në kete pike në Kodin Penal¹⁰ ose kundrvajtje administrative dhe referonte në ligjin nr.7697, date 7.4.1993 "*Për kundërvajtjet administrative*" me plotësimet e mëvonshme. Megjithatë, aktorë të shoqërisë civile u ankuan vazhdimisht se ligji 8503 nuk përmbante vetë një kapitull të mirfilltë sanksionesh të cilat të aplikohen ndaj zyrtarit, entit publik apo institucionit që refuzon të japë informacionin e kërkuar konform dispozitive të ligjit.

Ligji i vjetër gjithashtu nuk parashikonte krijimin e ndonjë autoriteti të pavarur i cili të funksionojë si mekanizëm garantues për zbatimin e dispozitive të ligjit¹¹.

Zbatimi i ligjit u kompromentua nga dominimi i kultures administrative të sekretit, tipike kjo sidomos për shoqëritë e dala nga rregjime totalitare. Po ashtu, kultura e pakët demokratike e shqiptarëve në kohën e adoptimit të këtij mekanizmi ligjor nuk e ndihmoi procesin e zbatimit të ligjit në praktikë. Moszbatimi i ligjit 8503 çoi rrjedhimisht në cënim të garancive kushtetuese, duke u kthyer në një barrë ndaj sitemit të brendshëm legjislativ në tërësi, e cila duhej shkarkuar me patjetër.

Në nivel të qeverisjes vendore, ligji i vjetër 8503 pothuajse nuk gjeti zbatim fare, pothuajse përgjatë gjithë kohës që ai ishte në fuqi. Aktorët e shoqërisë civile që kanë punuar në nivel vendor nuk e konsideruan këtë ligj si mjet efikas për të siguruar informacion nga bashkitë apo komunat. Megjithatë përpjekjet për promovimin e përdorimit të ligjit nga disa organizata me shtrirje kombëtare, ai nuk u zgjodh asnjëherë si një "arme e preferuar" për të sfiduar kulturën e sekretit në administratën vendore. Nuk u shënuar asnjë rast i vetëm i përdorimit të mekanizmit ligjor në nivel të komunave (mbi 300 në gjithë RSH). Një nga arsytet e dështimit masiv të ligjit 8503 në nivel vendor ka qenë fragmentarizimi i i madh i NJQV.

Aktorët e shoqërisë civile ngritën shqetësime serioze për këtë ralisht ligjor fiktiv sa i takon zbatimin të drejtës për informim. Ata kërkuar që në vitin 2008 abrogimin e ligjit 8503 dhe zëvendësimin e tij me një ligj të ri që t'i perkthente realisht në praktike garancite kushtetuese të RSH. Përpjekjet e shoqërisë civile për të "çmontuar" mekanizmin jo-efektiv "te prodhuar" nga elita politike (pra nga lart-poshtë) zgjatën plot 7 vjet. Përpjekjet thuhet se u braktisën në periudhën 2009-2013. Ato i ri-aktivizuan energjikisht pas rotacionit të pushtetit në vitin 2013. Këtë herë adoptimi i një legjislacioni krejt të ri për të Drejtën e Informimit vinte si një kërkesë edhe në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE.

¹⁰ Ligj, Nr. 7895, Dt. Aktit: 27.01.1995, Dt. Miratimit: 27.01.1995, Flet. Zyrtare Nr. 2, Faqe: 23

¹¹ Modeli i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë është ankimi në rrugë administrative sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, dhe pas shterrimit të ankimit administrativ, mund të drejtohet gjykatës në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Civile, një procedurë kjo jashtëzakonisht konsumuese në terma të kohës, por edhe në terma financiarë për cilindo subjekt që pretendon se i janë shkelur të drejtat për të marrë informacion përmes ligjit 8503

4. Kuadri i ri ligjor për të drejtën për informim ne Shqipëri

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin SOROS (Shoqëria e Hapur për Shqipërinë) në vitin 2014 ri-hapën procesin legjislativ aq-shumë të kërkuar dhe nisën draftimin e një projektligji të ri “Për të drejtën e informimit”¹². Numri i ndryshimeve të propozuar prekte në një masë të konsiderueshme dispozitat e ligjit 8503, kështu që u vendos hartimi i një ligj krejt i ri¹³.

Pas draftimit, projektligji u konsultua gjerësisht me aktorët e interesit, kryesisht nga shoqëria civile gjatë vlerësimit legjislativ në Komisionin Parlamentar të Ligjeve¹⁴. Projektligji u miratua në seancë plenare në datë 18.09.2014 me 78 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim. Ligji i ri u botua në Fletore Zyrtare nr. 160, të datës 17 tetor 2014. Me një përlllogaritje të thjeshtë, ligji i ri 119/2014 ka hyrë zyrtarisht në fuqi 15 ditë pas botimit, konkretisht në datë 2 Nëntor 2014.

Këtë herë, instrumenti legjislativ ishte një iniciative ligjvënëse nga “poshtë-lart”.

Ligji 119/2014 mbart risi të cilat dukshëm synojnë të sigurojnë zbatimin praktik të së drejtës së informimit në Shqipëri, si dhe një sistem të llogaridhënies lidhur me të. Me të rëndësishmet ndër to janë:

- *Garantimi i të drejtës për informim pa shpjeguar motivet;*
- *Përcaktimi i dy kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe me kërkesë;*
- *Hartimi dhe miratimi i programeve të transparencës, ku përfshihen kategoritë e informacionit publik pa kërkesë;*
- *Roli i koordinatorit për të drejtën e informimit dhe parashikimi i kompetencave të tij;*
- *Afate të reja për shqyrtimin e kërkesave për informim si dhe ankesave që depozitohen pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;*
- *Parashikimet e rasteve të kufizimit të së drejtës për informim;*
- *Sistem gjobash dhe sanksionesh administrative për të rritur llogaridhënien e autoriteteve publike .*

Ligji “Për të drejtën e informimit” i ka atribuar, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kompetenca për të shqyrtuar ankesa, për të kryer hetime administrative, për të zhvilluar seanca dëgjimore me palët e deri në vendosjen e sanksioneve administrative, dënimit me gjobë. Ligji i ri përfshin një numër më të madh subjektsh që kanë detyrimin për të vënë në dispozicion të qytetarëve informacionin që prodhojnë ose disponojnë, duke filluar që nga institucionet e pushtetit qendror, pushtetit vendor, sistemi gjyqësor dhe prokuroritë e deri të shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve.

Gjithashtu ai detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar, dhe përditësuar programin e transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Parimi i aksesit të lirë në informacion dhe barazisë së kushteve për akses në të, është qasja proaktive për informacione që

¹² Procesi i ndryshimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” kishte filluar në fakt qysh prej vitit 2007 (Open Society Justice Initiative), por për arsye që mbeten jo fort të kuptueshme, klasa vendimarrëse politike e mbajti në sirtar për një kohë të gjatë projektligjin e propozuar.

¹³ propozimi i një ligji amendues kur ka ndryshime të konsiderueshme ne trupin e aktit bie në kundërshtim me rregullat e teknikës legjislativë, pasi do të shkaktonte konfuzion e, njëdhimisht, do të cenonte parimin e sigurisë juridike.

¹⁴ Z. Andi Dobrush, drejtor ekzekutiv i Fondacionit Soros, u shpreh zyrtarisht pas miratimit të ligjit se “procesi ishte një histori suksesi e bashkëpunimit të gjithë aktorëve të shoqërisë civile që bënë të mundur lobimin dhe garantuan përfshirjen e grupeve të interesit, si edhe e bashkëpunimit të treguar nga institucionet shtetërore”.

promovojnë interesin publik të përcaktuar në drejtim të dhënies së informacionit, duke lejuar akses në të njëjtën kohë të informacionit për numër të papërcaktuar të njerëzve.

Kufizimet mbi aksesin në dokumenta zyrtare janë parashikuar në ligj duke synuar balancën midis interesit publik dhe dëmit që mund të vijë nga dhënia e informacionit. Prandaj është e rëndësishme të theksohet se kur prevalon interesi publik e drejta për informim nuk kufizohet.

Por risia më e suksesshme e ligjit për të Drejtën e Informimit është hartimi dhe miratimi i "programit institucional të transparencës". Programi institucional i transparencës, në thelb konsiston në tërësinë e informacionit që duhet të bëhet publik *ex officio* (pa kërkesë) nga autoriteti publik. Titullari i organit publik duhet të miratojë: a) kategoritë e informacionit që duhet të bëhet publik *ex officio*, dhe b) mënyrat apo modalitetet e bërjes publike të tij nga ana e autoritetit publik. Autoriteti publik duhet ta përgatisë këtë informacion paraprakisht në një format lehtësisht të kuptueshëm dhe të aksesueshëm, dhe ta publikojë në faqen përkatëse të internetit. Programet e transparencës duhet të rishikohen periodikisht në varësi të natyrës së autoritetit publik në fjalë, por jo më vonë se çdo 5 vjet.

Ndër risitë shumë pozitive të ligjit të ri është përdorimi i teknologjive të reja të informacionit dhe njohja zyrtare e përdorimit të formateve dixhitale. Blloqet kryesore të implementimit të ligjit, sic janë Programet e Transparencës, informacioni i ofruar në mënyrë proaktive, afishimi i kontakteve të koordinatorëve si dhe regjistri i pyetje-pergjigjeve parashikohen të jenë të publikuar në internet, kryesisht në faqet zyrtare të autoritetit publik por edhe të autoritetit mbikqyrës.

Ligji 119/2014 caktoi afatin 6 muajor për implementimin e këtyre programeve¹⁵. E përkthyer në data konkrete, data 3 Maj 2015, duhet të ishte afati i fundit për autoritetet publike për të garantuar zbatimin e kërkesave eksplicite të ligjit 119/2014.

5. E drejta e Informimit dhe Qeverisja Vendore pas RAT

Ligji i ri "Për të Drejtën e Informimit" nuk gjeti zbatim të menjëhershëm në nivel të qeverisjes vendore. Disa muaj para miratimit të tij, Me 31 Korrik 2014, Kuvendi miratoi ligjin 115/2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njësisive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Ndarja e re krijonte 61 bashki (në vend të 373 bashki e komuna) në nivelin e parë të qeverisjes vendore.

Në këto kushte, implementimi i ligjit 119/2014 në nivel vendor ishte i kondicionuar *objektivisht* të fillonte pas bërjes efektive të ndarjes së re administrative-territoriale. Kjo e fundit u aktivizua nga Zgjedhjet Vendore të 21 Qershorit 2015, të cilat prodhuan vetëm 61 bashki të medha në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Konstituimi i organeve të reja të qeverisjes vendore përfundoi në periudhën Korrik-Shtator 2015, ose rreth një vit pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri "Për të Drejtën e Informimit". Ndër detyrat që shtroheshi tashmë për zgjidhje për kryetarët e rinjë të bashkive të mëdha ishte edhe riformatimi i stafeve si dhe adoptimi i kërkesave/praktikave të reja ligjore. Me konsituimin e

¹⁵ Neni 4 "Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës" 1. Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

organeve drejtuese në Bashki, ri-filloi edhe ecja e afateve për caktimin e koordinatorëve të të drejtës së informimit dhe adoptimin e programeve institucionale të transparencës.

Me analogji, në datë 3 maj 2016, skadon de-fakto për bashkitë e reja të krijuara nga RAT afati për të garantuar zbatimin e kërkesave eksplicite të ligjit 119/2014 sa i takon programeve të transparencës, caktimit të kordinatorëve dhe afishimit të regjistarve të pyetje-përgjigjeve.

Për t'ju përgjigjur realitetit të ri të krijuar nga RAT në nivel vendor, Kuvendi miratoi në 5 Dhjetor 2015 edhe një ligj krejt të ri kuadër “Për vete-Qeverisjen Vendore”. Ligji i ri 139/2015 ka integruar për herë të parë një kapitull ligjor të dedikuar për Transparencën në nivel vendor. Kreu VI i ligjit në fjalë përcakton qartësisht detyrimin për të garantuar të drejtën e informimit dhe të drejtën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen e organeve të qeverisjes vendore.

Në nenin 15 të këtij Ligji është përcaktuar që njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.

Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

Neni 18 i ligjit 139/2015 referon në mënyrë të drejtpërdrejtë ligjin 119/2014 teksa përcakton shprehimisht se: *“Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim”.*

Neni 19 “E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes” gjithashtu përcakton se:

1. *Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t’u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë- qeverisjes vendore.*

2. *Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t’i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.*

Ligji 139/2015 “Për vetë Qeverisjen Vendore” u botua në Fletore Zyrtare nr. 249¹⁶ që mban datën 14 Janar 2015. Me njëpërlllogaritje të thjeshtë rezultoi se ai ka hyrë në fuqi më 29 Janar 2016, duke caktuar një moment kulmor të RAT dhe duke hapur rrugën *de-jure* implementimit të plotë edhe të ligjit 119/2014 “**Për të Drejtën e Informimit**”, tashmë edhe në nivel të qeverisjes vendore.

Në datë 3 maj 2016 mbushen 4 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji shumë të rëndësishëm dhe vlerësimi i mëposhtëm aplikohet edhe për të gjitha përcaktimet e sipër-përmendura (përfshirë publikimin e vendimeve të keshillave bashkiake).

Data 3 maj 2016 përkon edhe me ditën ndërkombëtare të Medias (lirisë së shprehjes) e drejtë e cila mundësohet substancialisht edhe nga mekanizmi i të drejtës për informim. Ky vit përkon edhe me 250 vjetorin e ligjit të parë anti-censure, që njihet edhe ligji i parë i të drejtës për informim, miratuar në Suedi në vitin 1766 (**Freedom of the Press Act**, Konglige Majestäts Nådige Förordning, Angående Skrif- och Tryck-friheten)

¹⁶ http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/249.pdf

6. Mbi monitorimin e realizuar nga INFOCIP dhe qasjen metodologjike

Objekt vlerësimi në kuadër të këtij studimi kombëtar janë 5 komponentë thelbësore që përbëjnë kusht parësor (infrastrukturor) për implementimin e ligjit 119/2014 në nivel të qeverisjes vendore. Infrastruktura që vlerësohet në këtë rast konsiston ne:

- I. **prania/pasja e faqeve zyrtare të internetit** (2 pike)
- II. **publikimi i programeve të transparencës** (3 pike)
- III. **publikimi i Regjistrisë të Kërkesave** (1 pike)
- IV. **caktimi i Kordinatorit të DPI dhe afishimi i kontakteve të tij** (2 pike)
- V. **publikimi i vendimeve të këshillave bashkiakë** (2 pike)

Vendimet e këshillave bashkiake janë aktet më të rëndësishme me të cilat disponojnë bashkitë dhe publikimi i tyre është një kërkesë e dyfishtë që buron si nga interpretimi i nenëve të ligjit 119/2014 “**Për të drejtën e Informimit**”, ashtu dhe nga përcaktimet eksplicite të ligjit 139/205 “**Për Vetëqeverisjen Vendore**”.

Është e qartë se mungesa e infrastrukturës bazë, faqet zyrtare të internetit, do të kompromentonte zbatimin rigoroz të blloqeve të tjera (ligjvënsi ka impikuar qartësisht në ligj aksesin efektiv online sidomos për programet e transparencës që përmbajnë edhe grupin më të qënësishmë të informacionit që bëhet publik pa kërkesë).

Katër blloqet infrastrukturorë të mësipërme janë një detyrim i pastër ligjor ndaj bashkive dhe mos-implemmentimi i tyre i ngarkon ato me përgjegjësi përpara ligjit, por edhe ndaj autoritetit mbikqyës, i cili në këtë rast ka tagrin të aplikojë sanksione ndaj tyre.

Për të lehtësuar kuptimin edhe Media por edhe nga publiku i gjeretë i të dhënave që merr përsipër të sjellë ky studim, INFOCIP ka krijuar një sistem pikëzimi të thjeshtë që është i njëjtë me vlerësimin klasim në sistemin tonë arsimor, pra nga 1 deri në 10.

Pas aplikimit të sistemit të pikëzimit, INFOCIP ka listuar (*ranking*) 61 bashkitë sipas rezultatit të grumbulluar, duke filluar nga nota më e lartë tek nota më e ulët. Kjo listë cakton edhe terrenin “zero” nga i cili mund të matet progresi/regresi në muajt në vijim.


Për efekt të kuptimit sa më të thjeshtëuar të të dhënave të këtij vlerësimi kombëtar, grupi i ekspertëve ka organizuar 61 bashkitë e RSH në dy grupime: ato që kanë “notë kaluese” dhe ato që marrin “notë jo-kaluese” sa i takon zbatimin të kërkesave bazë, ose thënë ndryshe “detyrat e Shtëpisë”, për të cilat ligji 119/2014 adreson direkt bashkitë, si subjekte të zbatimit të tij.

Studimi merr në analizë cilësore vetëm **programet e transparencës** që duhet të jenë të përgatitura/adoptuara dhe të afishuara nga bashkitë. Kjo analizë është realizuar për të testuar një metodologji vlerësimi, më shumë sesa për të gjeneruar të dhëna të kuadër të vlerësimit parësor, pra për infrastrukturën e domosdoshme që e bën ligjin 119/2014 të implementueshëm në nivel të bashkive. Analiza cilësore e programeve të transparencës nuk ka efekt mbi sistemin e pikëzimit; ky i fundit duhet kuptuar si një “fotografi çasti” që fikson pasjen ose jo të programeve të transparencës dhe jo cilësinë e tyre momentale. Çdo e dhënë është administruar nga ekipi i kërkuesve të INFOCIP si një *screen-shot* e faqeve të bashkive. *Set-i* i parë është arkivuar në Shkurt 2016 kurse rakordimet e fundit janë mbuluar në 30 prill 2016.

Është e qartë se ky monitorim nuk merr përsipër të vlerësojë shkallën e gatishmërisë së bashkive për të dhënë informacion pas vënies në lëvizje përmes kërkesave për informim (informimi aktiv).

b) Programet e Transparencës

Një vit pas skadimit të afatit që catonte ligji 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” dhe thuajse një vit pas aktivizimit të ndarjes së re territoriale, vetëm 9 bashki kanë adoptuar Programet e Transparencës (me ngjyrë mavi në hartën në të majte). Keto bashki janë: Elbasan, Himara, Kavaje, Kukës, Lezhë, Mat, Vlorë, Vorë dhe Shkodra. Bashkia Mat ka të vendosur në faqen vetëm ikonën e programit të transparencës por nuk ka asnjë dokument të publikuar në të. Nga vlerësimi i bërë rezultoi se në faqen e internetit ka gjithsesi shumë materiale të publikuara por ato nuk janë të linkuara në programin e transparencës.



Harta e re Administrative e Programeve të Transparencës	Bashkitë që nuk kanë P.Transparencë (sipas rendit Alfabetik)
	<ul style="list-style-type: none"> Belsh Berat Bulqizë Cerrik Delvine Devoll Diber Divjake Dropull Durrës Fier Finiq Fushë-Arrëz Gjirokastër Gramsh Has Kamez Kelcyr Klos Kolonjë Konispol Korçë Krujë Kuçovë Kurbin Libohovë Librazhd Lushnjë M. e Madhe Maliq Mallakastër Memaliaj Mirditë Patos Peqin Permet Pogradec Polican Prrenjas Pukë Pustec Roskovec Rrogozhin Sarandë Selenicë Shijak Skrapar Tepelene Tiranë Tropojë U.Vajgurore, Vau-Dejë

Rekomandim bazë: *te caktohet një afat i ri administrativ për të gjitha bashkitë që kanë tashmë faqe interneti për të adoptuar dhe publikuar programet e transparencës. Të aplikohen sanksionet ligjore ndaj bashkive që nuk respektojnë kërkesat e ligjit pas afatit që do të ri-caktojë autoriteti mbikqyrës. Të ndihmohen bashkitë që nuk kanë faqe interneti që të pajisen sa më parë me to, për të garantuar infrastrukturën e domosdoshme për përmbushjen e kërkesave të ligjit 119/2014.*

c) Regjistri i Pyetje-Pergjigjeve dhe d) Koordinatori i LDI

Ligji 119/2014 i cakton detyrimin autoritetit publik që të mbajë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve (Neni 8). Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër. Nga vlerësimi i ndërmarrë nga INFOCIP rezultoi se vetëm 6 bashki kanë të publikuar një regjistër të tillë: Himara, Kavaja, Lezhe, Vlora, Vora dhe Shkodra (në të majtë të tab.2) Regjistrat janë të ne shumicën e tyre të papërditësuar.


Po ashtu ligji 119/2014 i cakton Autoritetit Publik, në rastin tonë bashkive, detyrimin për caktimin e koordinatorëve të Informimit. Ky është një person kyc në implementimin e kërkesave të ligjit dhe që mban përgjegjësi direkte në rast mos-përmbushjeje. Nga të dhënat rezultoi se deri në 30 prill 2016 ishin janë caktuar në këtë funksion 41 persona. Kjo do të thotë që ende 20 bashki nuk e kanë përmbushur akoma detyrimin ligjor.

Harta e Regjistrat te Pyetje-Përgjigjeve	Harta e Kordinatorëve të LDI
	

Rekomandim bazë: Lidhur regjistrin e Pyetje-Pergjigjeve mund të aktivizohet edhe njëherë të fundit një korespondence (praktikë shkresore) nga ana e Autoritetit Mbikqyrës, duke prioritarizuar bashkitë që kanë faqe inetrneti dhe ne rast të mospërmbushjes së detyrimit ligjor të fillojë aplikimi i sanksioneve ligjore. Lidhur me caktimin e koordinatorëve, duhen marrë masa të menjëhershme që procesi të kompletohet në të 61 bashkitë e RSH, në të kundër të fillojë aplikimi i sanksioneve ligjore ndaj titullarëve të bashkive

d) Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak


Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak është një detyrim që buron nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e Inforimitit” dhe gjithashtu nga ligji organik 139/2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”. Nga vlerësimi i ndërmarrë rezultojnë se nga 61 bashki gjithsej, vetëm 14 prej tyre kanë vendime të publikuara online. Këto bashki janë: Shkoder, Durres, Korce, Vlore, Fier, Lushnje, Berat, Gramsh, Skrapar, Divjake, Permet, Lezhe, Kruje, Kucove. Prej këtyre bashkive, me përjashtim të Shkodrës dhe Lezhës, pjesa tjetër janë të asistuar nga INFOCIP për të përmbushur këtë detyrim ligjor duke iu vënë në dispozicion platformën kombëtare VENDIME.AL. Bashkia e Tiranës ka patur një sistem konsistent deri në vitin 2011 të publikimit të vendimeve online. Deri në vitin 2015 ky tregues pesoi rënie. Nuk rezultojnë të ketë rikuperim as pas vitit 2015. Disa bashki të tjera publikojnë vendime, por ato janë të papërdorshme online, pasi hidhen si liste titujsh dhe nuk hapin asnjë brendi. Në fazën III të programit të publikimit të vendimeve online bashkitë përfutuese kanë qenë Divjakë, Skrapar, Gramsh dhe Përmet (mbështetur nga Ambasada e SHBA, Tiranë). Në proces aktualisht janë bashkitë Kamëz, Pukë dhe Kukes. Faza IV e zgjerimit po mbështet nga Olof Palme Center.

Harta e Publikimit të Vendimeve	Çfarë është VENDIME.AL
	<p>VENDIME.AL është platforma online ku publikohen vendimet e këshillave bashkiakë të Republikës së Shqipërisë që prej vitit 2007. Portali përfaqëson Arkivën Kombëtare të Akteve Legjislative të pushtetit vendor. Ai është në zgjerim të vazhdueshëm me bashki të reja, sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale.</p> <p>Përmes VENDIME.AL kushdo njiheni shpejt, në çdo kohë dhe pa pagesë me vendimet e këshillit bashkiak. Publikimi i vendimeve dhe njoftimi i tyre efektiv është një detyrim ligjor që buron nga ligji i ri 139/2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”.</p> <p>VENDIME.AL i shërben bashkive të Shqipërisë për të realizuar njoftimin e akteve subjektive që kanë nën juridiksion si një detyrim që rrjedh nga ligji i ri 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, (neni 18 dhe 55) edhe në teresi nga ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Inforimitit”</p>


Rekomandim bazë: Të gjitha bashkitë duhet të publikojnë urgjentisht vendimet e këshillit bashkiak. Bashkia e Tiranës duhet urgjentisht të rikuperojë problemin e mos-publikimit të vendimeve të saj dhe të restaurojë rendin indeksues. Për të gjitha bashkitë që nuk kanë faqe, INFOCIP ve në dispozicion platformën kombëtare VENDIME.AL për të përmbushur përmes saj detyrimin ligjor. Autoriteti mbikqyrës të mund të facilitojë brenda mundësive procesin e pajisjes me infrastrukture online botimi për ato bashki që nuk kanë website akoma

e) Paraqitja grafike e gjetjeve te studimit kombëtar monitorues


Bashkite me website vs. Bashki pa website




Adoptimi i Programeve të Transparences




Adoptimi i Regjistrit të Pyetje-Pergjigjeve




Caktimi i Koordinatorit të DI ne bashki



Publikimi i vendimeve te keshillave bashkiake ne internet



Niveli i zbatimit te ligjit 119/2014 nga 61 bashkite per 5 komponentet se bashku




f) Tabela vleresuese me pike per 61 bashkite per 5 komponentet e zbatimit te ligjit
119/2014 (renditja sipas pikeve te grumbulluara dhe sipas rendit alfabetik)

Bashkia	Website	P Transparence	Regjister	Koordinator	Vendime	Pike
Matrica e Pikezimit	2	3	1	2	2	Totali max. 10
Lezhe	2	3	1	2	2	10
Vlorë,	2	3	1	2	2	10
Shkoder	2	3	1	2	2	10
Kavaje	2	3	1	2	0	8
Vore	2	3	1	2	0	8
Kukes	2	3	0	2	0	7
Elbasan	2	3	0	2	0	7
Mat	2	3	0	2	0	7
Durres	2	0	0	2	2	6
Fier	2	0	0	2	2	6
Korce	2	0	0	2	2	6
Kucove	2	0	0	2	2	6
Lushnje	2	0	0	2	2	6
Skrapar	2	0	0	2	2	6
Kruje	2	0	0	2	2	6
Berat	2	0	0	2	2	6
Himara	2	3	1	0	0	6
Diber	2	0	0	2	0	4
Fush-Arrez	2	0	0	2	0	4
Tirane	2	0	0	2	0	4
Sarande	2	0	0	2	0	4
Divjake	0	0	0	2	2	4
Permet	0	0	0	2	2	4
U. Vajgurore	0	0	0	2	1	3
Polican	0	0	0	2	0	2
Gramsh	0	0	0	0	2	2
Vau-Dejës	0	0	0	2	0	2
Belsh	0	0	0	2	0	2
Bulqiz	0	0	0	2	0	2
Cerrik	0	0	0	2	0	2
Delvine	0	0	0	2	0	2
Gjirokaster	2	0	0	0	0	2
Kamez	2	0	0	0	0	2
Klos	0	0	0	2	0	2
Konispol	0	0	0	2	0	2
Librazhd	0	0	0	2	0	2
Tepelen	0	0	0	2	0	2
Mallakaster	0	0	0	2	0	2
Memaliaj	0	0	0	2	0	2
Mirdite	2	0	0	0	0	2

Patos	0	0	0	2	0	2
Peqin	0	0	0	2	0	2
Pogradec	0	0	0	2	0	2
Puke	2	0	0	0	0	2
Pustec	0	0	0	2	0	2
Roskovec	0	0	0	2	0	2
Shijak	0	0	0	2	0	2
Kurbin	0	0	0	0	0	0
Maliq	0	0	0	0	0	0
Devoll	0	0	0	0	0	0
Dropull	0	0	0	0	0	0
Finiq	0	0	0	0	0	0
Has	0	0	0	0	0	0
Kelcyr	0	0	0	0	0	0
Kolonje	0	0	0	0	0	0
Libohove	0	0	0	0	0	0
M. e Madhe	0	0	0	0	0	0
Prrenjas	0	0	0	0	0	0
Rrogozhin	0	0	0	0	0	0
Selenice	0	0	0	0	0	0
Tropoje	0	0	0	0	0	0
Devoll	0	0	0	0	0	0

g) Paraqitja grafike: note kaluese (mbi 4) vs. Notë jo-kaluese (nën 4)



Ky grafik paraqit në menyre të thjeshtëzuar vlerësimin me “notë” të 61 bashkive ne raport me permbyshjen e “detyrave të shtëpise” që u ka caktuar tyre ligjvënësi (Kuvendi) përmes përcaktimeve eksplicite në ligjin 119/2014 “Per të Drejtën e Informimit”.

8. Vlerësimi cilësor i Programeve të Transparencës

Programi Transparencë është dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga autoritetet publike pa kërkesë¹.

Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit 119/2014 ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni (neni 4/1).

Në përgatitjen e projekt-programit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos: a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik; b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion; c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të ligjit 119/2014.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji (neni 6). Ky përcatim ligjor rezulton të jetë zbatuar plotësisht nga ana e autoritetit mbikqyrës. Ky është një pohim që bën pjesë në set-in e gjetjeve të bëra publik në kuadër të monitorimit.

Sipas udhëzimeve online², të bëra publike nga autoriteti mbikqyrës, programet e transparencës duhet të jenë krijuar në çdo autoritet publik që pas datës 6 maj 2015 dhe duhet të jenë publikuar në faqet e tyre të internetit. Këto programe duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- b) tekste dhe plota të konventave të ratifikuara, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të çdo dokumenti politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- d) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- e) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- f) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- g) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.
- h) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjore në fushë, duke përfshirë:
 - i) listën e kontratave të lidhura;
 - ii) shumën e kontraktuar;

¹ <http://pyetshtetin.al/cfare-quhet-program-transparence/>

² <http://pyetshtetin.al/cfare-quhet-program-transparence/>

- iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
- iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, udhëzues e politika të ndryshme;
- j) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet e shërbimit;
- k) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;
- l) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyrë tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- m) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- n) një kopje të përditësuar të Rregjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- o) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;
- p) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;
- q) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Sikurse u përmend më sipër, në kuadër të monitorimit të ndërmarrë nga INFOCIP (Kapitulli I), rezulton se nga 61 Bashki të reja të krijuar nga RAT, vetëm 26 kanë faqe interneti. Nga një vlerësim i brendisë së këtyre faqeve, rezulton se, deri në datën 30 prill 2016, vetëm 9 prej tyre kanë të publikuar në faqet zyrtare programin e transparencës, konkretisht: Bashkia Lezhë, Vlorë, Elbasan, Kavajë, Mat, Vore, Himare, Kukes, Shkoder.

